



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.27

Prishtinë, më 5.10.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N 302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Srdjan Popoviq , Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyçi dhe Mufera Shinik.

Pjesëmarrës të tjerë: Hysen Bytyçi – MASHT, Rexhep Ismajli, Jusuf Krasniqi, Lindita Pula – ASHAK, dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Maturën Shtetërore;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me heqjen e pikës së shqyrtimit të Projektligjit për Maturën Shtetërore.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Anëtarët e Komisionit shqyrtuan nen për nen Projektligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe propozuan këto amendamente:

Amendamenti 1

Emërtimi i ligjit në gjuhën angleze duhet të jetë:

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

Amendamenti 2

Neni 1 riformulohet si vijon:

Qëllimi i këtij ligjit është rregullimi, organizimi dhe aspekte të tjera të funksionimit të përgjithshëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (në tekstin e mëtejme Akademia).

Amendamenti 3

Neni 2 riformulohet si vijon:

1. Akademia është institucioni më i lartë i shkencës dhe i artit i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
2. Republika e Kosovës siguron kushte për punë dhe zhvillim të Akademisë.
3. Akademia është institucion i pavarur në fushën e shkencës dhe të artit.

Amendamenti 4

Neni 5 riformulohet si vijon:

Akademia është person juridik publik me të drejta, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara me këtë ligj dhe akte të brendshme të Akademisë.

Amendamenti 5

Neni 6, paragrafi 1,2 dhe 3, riformulohet si vijon:

1. Statuti i Akademisë, në përputhje me këtë ligj, përcakton organizimin, mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve dhe të organeve të punës dhe të qeverisjes së Akademisë.

2. Statutin e Akademisë e miraton Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës me 2/3 e të gjithë anëtarëve.

3. Akademia ka akte të tjera të përgjithshme, me të cilat, në harmoni me Statutin e Akademisë, i rregullon çështjet e rëndësishme për punë.

Amendamenti 6

Neni 8, nënparagrafi 1.1, riformulohet si vijon:

1.1. Realizimit të projekteve shkencore me interes për zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të vendit;

Amendamenti 7

Neni 8, nënparagrafi 1.9 dhe 1.10, riformulohet si vijon:

1.9. Bashkëpunimit me institucionet e Republikës së Kosovës dhe me institucionet ndërkombëtare nga fusha e shkencës dhe e artit;

1.10. Krijimit të kushteve për përhapjen e mendimit shkencor dhe të krijimtarisë artistike jashtë vendit;

Amendamenti 8

Neni 8, nënparagrafi 1.12, riformulohet si vijon:

1.12. Zhvillimit të hulumtimeve me interes të veçantë publik e shkencor;

Amendamenti 9

Neni 8, nënparagrafi 1.13, riformulohet si vijon:

1.13 Ndërmarrjes së veprimeve në interes të veçantë për Kosovën, në mbështetje të së drejtës dhe të detyrimit të Akademisë për të qenë institucion këshillues për zhvillimin e shkencës dhe të artit në Kosovë, në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit.

Amendamenti 10

Neni 9, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Me qëllim të avancimit të punës kërkimore-shkencore dhe artistike me interes të përgjithshëm për shkencën dhe për artin në Kosovë, Akademia themelon seksione, institute hulumtuese dhe qendra studimore.

2.Në realizimin e funksioneve të saj, Akademia bashkëpunon me institucionet shkencore dhe akademike të arsimit të lartë, institutet shkencore, entitetet ekonomike , agjencitë shtetërore, si dhe me punëtorët e hulumtuesit shkencorë nga fushat e ndryshme të shkencës dhe të artit.

Amendamenti 11

Neni 10, paragrafi 1, fshihet fjala “veçanërisht”.

Amendamenti 12

Neni 10, nënparagrafi 1.2, riformulohet si vijon :

1.2. Pranimin e anëtarëve të rinj në përputhje me standardet më të larta të veprimtarisë shkencore dhe të krijimtarisë artistike.

Neni 10, nënparagrafi 1.3, 1.4, 1.7, riformulohet si vijon :

1.3. Bashkëpunimin e rregullt me institucionet e Republikës së Kosovës, akademitë simotra jashtë vendit, si dhe me organizata shkencore ndërkombëtare me qëllim të komunikimit të ndërsjellë shkencor e artistik dhe të integritetit në rrjedhat botërore të shkencës dhe të artit;

1.4. Realizimin e projekteve me qëllim të ndërtimit të strategjive të zhvillimit të gjithëmbarshtëm të vendit;

1.7. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të përcaktuara në Statutin e Akademisë dhe në aktet normative të saj.

Amendamenti 13

Neni 11, paragrafi 1,2,3,4,6,7, riformulohen si vijon :

1. Aktiviteti shkencor e artistik i Akademisë zhvillohet në kuadër të seksioneve, të instituteve hulumtuese dhe të qendrave të tjera studimore;

2. Seksionet janë bartëse të të drejtave, detyrave dhe përgjegjësiave të Akademisë për fushat shkencore e artistike për të cilat janë themeluar;

3. Në seksionet e Akademisë veprojnë anëtarë të rregullt dhe korrespondentë të fushave përkatëse shkencore e artistike;

4. Anëtar i rregullt dhe korrespondent i Akademisë mund t’i takojë vetëm një seksioni të një fushe apo njësie përkatëse shkencore apo artistike;

6. Punën e instituteve hulumtuese dhe të qendrave të tjera studimore e drejton drejtori ose organi përkatës drejtues;

7. Organizimi dhe puna e seksioneve, instituteve hulumtuese dhe qendrave të tjera studimore të Akademisë, përcaktohet me Statutin e Akademisë dhe me aktet e veçanta normative.

Amendamenti 14

Neni 13 riformulohet si vijon:

1. Kuvendi është organi më i lartë vendimmarrës i Akademisë.
2. Kuvendin e përbëjnë të gjithë anëtarët e rregullt dhe korrespondentë të Akademisë.
3. Në punën e Kuvendit mund të marrin pjesë edhe anëtarët e jashtëm të Akademisë, pa të drejtë vote.
4. Kryesia e Akademisë e thërret Seancën e Kuvendit.
- 4.2. Më së paku dy seksione të Akademisë;
- 4.3. 10 anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë.

Amendamenti 15

Neni 14 riformulohet si vijon:

- 1.2.Miratimin e udhëzimeve, rregulloreve dhe të akteve tjera normative të Akademisë;
- 1.3. Themelimin e instituteve hulumtuese dhe të qendrave studimore;
- 1.4.Miratimin e programit të punës të Akademisë;
- 1.5. Miratimin e buxhetit vjetor, planit financiar dhe llogaritë përfundimtare të Akademisë;
- 1.6.Miratimin e raportit të punës të Akademisë;
- 1.7. Fshihet.
- 1.8. Zgjedhjen e anëtarëve të rregullt, korrespondentë, të jashtëm dhe të nderit të Akademisë;
- 1.10. Miraton zgjedhjen e sekretarëve të seksioneve të Akademisë;
- 1.11. Obligimet e tjera që përcaktohen me këtë ligj dhe me Statutin e Akademisë.

Amendamenti 16

Neni 15 riformulohet si vijon:

1. Kuvendi i Akademisë mund të mbledhet dhe të vendosë me pranimë të shumicës së anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë.
2. Për zgjedhjen e kryetarit, të nënkryetarit dhe të sekretarit shkencor të Akademisë, për miratimin e zgjedhjes së sekretarëve të seksioneve të Akademisë, si dhe për zgjedhjen e

anëtarëve korrespondentë, anëtarëve të jashtëm dhe të nderit të Akademisë, është e nevojshme shumica e votave të të gjithë anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë.

Amendamenti 17

Neni 16, riformulohen paragrafët si në vijim:

2. Kryesia e Akademisë bshkërendon punën e përgjithshme nga fusha e përgjegjësive të saj.
4. Kryesia e Akademisë i zbaton vendimet dhe qëndrimet e Kuvendit.
5. Anëtarët e Akademisë mbi moshën 75 vjeçare, nuk mund të ushtrojnë funksione udhëheqëse.(bartet tek dispozitat e përgjithshme)
7. Kryesia e Akademisë zgjidhet për një periudhë katërvjeçare me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

Amendamenti 18

Neni 17 riformulohet si vijon:

1. Kryetari i Akademisë :

- 1.1. Udhëheq punën e Akademisë;
- 1.2. Përfaqëson dhe e prezanton Akademinë;
- 1.3. Udhëheq punën e Kryesisë dhe të Kuvendit të Akademisë;
- 1.4. Zgjidhet nga Kuvendi i Akademisë për një periudhë katërvjeçare me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër;
- 1.5. Nënshkruan të gjitha vendimet e Kryesisë dhe të Kuvendit;
- 1.6. Përgjigjet për ligjshmërinë e punës së Akademisë;
- 1.7. Për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Akademisë, ndërsa në kuadër të të drejtave dhe detyrave të Kryesisë së Akademisë, i përgjigjet Kryesisë.

Komisioni, në mbledhjen e radhës, vijon me shqyrtimin dhe amendamentimin e projektiligjit, pas nenit 17.

2. Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani